



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:056887  
Datë: 31.10.2022  
Numri i dokumentit: 03585594

ARJ nr.103/2022

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit-propozusit , F.S. nga f. P. ,K. L., e përfaqëson me autorizim avokat Hajzer Salihu nga P., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, (KPMSHCK), me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar nga paditësi për mes përfaqësuesit të lartë cekur, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. 471/22 të datës 16.06. 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 31 Tetor 2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e pas afatshme kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi F. S., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 471/2022 të datës 16.06. 2022.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.708/22, të datës 10.05.2022, refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit-propozuesit F. S. me të cilën ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr. A.nr.07/22, dhe nr. prot. 1197/2022 i datës 04.03.2022, lëshuar nga KPMSHCK, deri në vendosjen e çështjes sipas padisë.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA nr. 471/22 të datës 16.06. 2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit F. S., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.708/22, i datës 10.05.2022 vërtetohet.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, paditësi për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, av. Hajzer Salihu parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit

gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të drejtës materiale, me propozim që kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe Gjykata Supreme ta ndryshoj aktvendimin e lartë cekur, duke vendosur në meritë për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit A nr. 07/2022 me nr. prot. 1197/2022, të dt. 04.03.2022, nxjerrë nga KPMSHCK.

Gjykata Supreme pas vlerësimit të afatit për paraqitjen e Kërkesë për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit gjyqësor, sipas nenit 24, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pas afatshme.

Me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet që kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrihet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes. Me nenin 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit pala e paraqet kërkesën.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA nr. 708/2022 të datës 16.06.2022, e ka pranuar me datë 29.06.2022, konstatohet në bazë të fletë dërgesës për dorëzim personal, ndërsa kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor për mes Shërbimit Postar, Rekomande, e ka dorëzuar me datë 01.08. 2022.

Nga konstatimet si më lartë provohet se kërkesa nga paditësit-propozuesit është paraqitur pas afatit ligjor 30 ditë, ashtu si parashihet me nenin 50 të LKA, prandaj e njëjta hedhet si e pas afatshme.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 52 paragraf 1, lidhur me nenin 24 dhe 50, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË**  
ARJ nr.103/2022, me datë 31 Tetor 2022

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani